




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT,

MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGjisë  
DHE INOVACIONIT

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS - FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE  
SPORTIT  
DHE

FEDERATËS SË SPORTIT SHKOLLOR TË KOSOVËS

## **1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT**

1.1.Qëllim i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është realizimi i aktiviteteve sportivo-edukative, përmes së cilave promovohen benefitet e aktivitetit fizik përmes edukimit jo-formal, dhe promovimi i kapaciteteve të Republikës së Kosovës për zhvillimin e sporteve malore, specifisht skijimit. Përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë për arrijen e qëllimeve të bashkëpunimit, përkatësisht, arrijen e objektivave dhe synimeve në fushën e politikave publike për mbështetjen e sportit, të përcaktuara në orientimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin, avancimin dhe masovizimin e sportit, si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sport. Në projekt parashihet të përfshihen rreth 400 nxënës të shkollave fillore të nivelit të arsimit të mesëm të ulët.

## **2. PALËT**

2.1. Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit do të përmbushet nga:

- 2.1.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS);
- 2.1.2. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- 2.1.3. Ministria e Shëndetësisë (MSH);
- 2.1.4. Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS);
- 2.1.5. Federata e Sportit Shkollor të Kosovës (FSSHK);  
(në tekstin e mëtejshmë: Palët).

## **3. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

3.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (më tutje MKRS) i kryen obligimet si në vijim:

- 3.1.1 MKRS do të mbështhes projektin në vlerë financiare 335,000.00 EUR;
- 3.1.2 MKRS përmes vendimit të sekretarit do të themelojë Këshillin Organizativ të projektit që ka për detyrë planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të projektit;
- 3.1.3 MKRS obligohet të bëjë mbikëqyrjen e implementimit të projektit me 1 përfaqësues të institucionit;
- 3.1.4 MKRS obligohet të koordinojë aktivitetet me partnerët e tjera të përfshirë në këtë memorandum në mënyrë që projekti të implementohet me sukses.
- 3.1.5 MKRS obligohet të sigurojë hapësirë të mjaftueshme për deponimin e pajisje sportive të projektit;

## **4. OBLIGIMET E MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

**4.1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (më tutje MASHTI) i kryen obligimet si në vijim:**

- 4.1.1 MASHTI do të bëjë përgjedhjen e 60% të numrit total të nxënësve që do të jenë pjesëmarrës në aktivitetet e projektit
- 4.1.2 MASHTI do të sigurojë stafin përcjellës të nxënësve pjesëmarrës të secilës klasë në aktivitetet e projektit (mësimdhënës, prindër, kujdestar);
- 4.1.3 MASHTI do të sigurojë që stafi përcjellës i nxënësve janë të vaksinuar me dy doza të vaksinës kundër Covid 19;
- 4.1.4 MASHTI do të bëjë përgjedhjen e shkollave dhe klasave pjesëmarrëse në aktivitetet e projektit bazuar në kriteret e konkurrencës;
- 4.1.5 MASHTI do të sigurojë lirimin e nxënësve dhe stafit përcjellës nga orari i rregullt mësimor gjatë periudhës së implementimit të projektit;
- 4.1.6 MASHTI obligohet të bëjë mbikëqyrjen e vazhdueshme të implementimit të projektit në terren me 1 përfaqësues të institucionit;
- 4.1.7 MASHTI obligohet që në bashkëpunim me MKRS, MSH, UP (FEFS) dhe FSSHK të hartojë programin e aktiviteteve jashtëkurrikulare të cilat do të implementohen gjatë projektit;
- 4.1.8 MASHTI obligohet të koordinojë aktivitetet me partnerët e tjerë të përfshirë në këtë memorandum në mënyrë që projekti të implementohet me sukses

## **5. OBLIGIMET E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

**5.1. Ministria e Shëndetësisë (më tutje MSH) i kryen obligimet si në vijim:**

- 5.1.1 MSH do të të sigurojë stafin e nevojshëm mjekësor përgjatë implementimit të projektit në terren;
- 5.1.2 MSH obligohet të sigurojë një ose/apo dy vetura të ambulantës përgjatë periudhës së implementimit të projektit;
- 5.1.3 Varësish nga masat e Qeverisë kundër pandemisë që do të jenë në fuqi në atë kohë, MSH do të ofrojë mbështetjen e nevojshme për testimin e nxënësve dhe stafit pjesëmarrës para, gjatë dhe pas implementimit të projektit;
- 5.1.4 MSH obligohet të koordinojë aktivitetet me partnerët e tjerë të përfshirë në këtë memorandum në mënyrë që projekti të implementohet me sukses.

## **6. OBLIGIMET E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS – FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT (FEFS):**

**6.1. Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit (më tutje FEFS) i kryen obligimet si në vijim:**

- 6.1.1 Obligohet të sigurojë stafin profesional të mësimdhënësve për implementimin e aktiviteteve të projektit;
- 6.1.2 Obligohet të hartojë plan programin/ kurrikulen e aktiviteteve sportive që do të implementohet gjatë orëve të skijimit;

- 6.1.3 Obligohet të bëjë prezantimin e planprogramit/ kurrikulës te shkollat pjesëmarrëse të projekteve;
- 6.1.4 FEFS obligohet të zhvillojë trajnim tre (3) ditor për të gjithë instruktorët e angazhuar në projekt;
- 6.1.5 FEFS obligohet të bëjë përgjedhjen e studentëve pjesëmarrës si instruktorë të projekteve bazuar në kriteret e konkurrencës;
- 6.1.6 FEFS obligohet të bëjë përgjedhjen e studentëve pjesëmarrës si vullnetarë të projekteve bazuar në kriteret e konkurrencës;
- 6.1.7 FEFS obligohet të sigurojë skitë, këpucët e skijimit dhe shkopinjtë për stafin profesional të mësimdhënësve;
- 6.1.8 FEFS obligohet të koordinojë aktivitetet me partnerët e tjerë të përfshirë në ketë memorandum në mënyrë që projekti të implementohet me sukses.

## 7. OBLIGIMET E FEDERATËS SË SPORTIT SHKOLLOR TË KOSOVËS (FSSHK)

7.1. Federata e Sportit Shkollor të Kosovës (më tuje FSSIHK) i kryen obligimet si në vijim:

- 7.1.1 FSSHK pranon mjetet financiare në vlerë prej 335,000.00 EUR;
- 7.1.2 FSSHK obligohet të paguajë shpenzimet e nevojshme për implementimin e projekteve siç është e përcaktuar në planin e aktiviteteve dhe planin buxhetor të projekteve;
- 7.1.3 FSSHK do të bëjë përgjedhjen e 40% të numrit total të nxënësve që do të janë pjesëmarrës në aktivitetet e projekteve;
- 7.1.4 FSSHK obligohet të bëjë përgjedhjen e përfaqësuesve të Shoqatave të Pedagogëve të Edukimit Fizik për pjesëmarrje në aktivitetet e projekteve;
- 7.1.5 FSSHK obligohet të organizojë ngjarjen e ditës hapëse dhe përmbyllëse të projekteve;
- 7.1.6 FSSHK obligohet të bëjë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve me 1 përfaqësues të organizatës;
- 7.1.7 FSSHK obligohet të sigurojë pajisjet e nevojshme të cilat janë të domosdoshme për implementimin e projekteve;
- 7.1.8 FSSHK obligohet të bëjë mirëmbajtjen e pajisjeve edhe pas përfundimit të projekteve;
- 7.1.9 FSSHK obligohet që në rastet me arsyeshmëri të vërtetuar t'i huazojë për shfrytëzim të përkohshëm pajisjet tek organizatat apo institucionet publike të cilat në programet e tyre e kanë pjesë programore promovimin dhe zhvillimin e sporteve dimërore;
- 7.1.10 FSSHK obligohet që në bashkëpunim me MKRS, MASHTI, MSH, dhe FEFStë hartojë programin e aktiviteteve jashtëkurrikulare të cilat do të implementohen gjatë projekteve;
- 7.1.11 FSSHK obligohet të koordinojë aktivitetet me partnerët e tjerë të përfshirë në këtë memorandum në mënyrë që projekti të implementohet me sukses.

## **8. TË DREJTAT E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT LIDHUR ME MBËSHITETJEN FINANCIARE**

- 8.1.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në secilën periudhë ka të drejtë që të kërkojë raport narrativ me shkrim nga Federata e Sportit Shkollor e Kosovës lidhur me realizimin e buxhetit sipas planit të aktiviteteve të saj në pajtim me politikat shtetërore të sportit;
- 8.2.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë që të kërkojë auditim të rregullt ose të jashtëzakonshëm, të brendshëm apo të jashtëm, për të audituar shpenzimin e buxhetit të saj nga ana e Federatës së Sportit Shkollor e Kosovës sipas qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit;
- 8.3.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në secilin rast kur vlerëson që mjetet financiare nuk janë duke u shfrytëzuar sipas qëllimit të këtij Memorandumi dhe në zbatim të politikave për zhvillimin dhe avancimin e sportit, ka të drejtë, që njëanshëm, të shkëpusë këtë Memorandum Bashkëpunimi dhe Federata e Sportit Shkollor e Kosovës është e obliguar t'i a kthejë mjetet buxhetore Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 8.4.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka të drejtë të ndërprejë njëanshëm këtë Memorandum Bashkëpunimi në rastet kur Federata e Sportit Shkollor e Kosovës i ka shpenzuar mjetet financiare për qëllime jo sportive apo për dukuri devijante që janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Sport dhe me rendin publik si dhe sigurinë e Republikës së Kosovës;
- 8.5.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në rast se ka informacion për keqpërdorimin e buxhetit nga Federata e Sportit Shkollor e Kosovës të ndarë sipas këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, nëse e vlerëson, ka të drejtë që të kërkojë hetim nga institucionet kompetente të ndjekjes penale;
- 8.6.** Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit nuk mbanë asnjë përgjegjësi nëse buxheti i saj i cili i jetet Federatës së Sportit Shkollor e Kosovës keqpërdoret nga përfaqësuesit e Federatës;
- 8.7.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mund të ndajë mjete shtesë për Federatën e Sportit Shkollor e Kosovës nëse vlerëson se ndarja e këtyre mjetetëve financiare është me rëndësi për zhvillimin e sportit, është në përputhje me politikat e sportit apo i shërben arritjes më të suksesshme të qëllimit të përcaktuar në këtë MiB;
- 8.8.** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka të drejtë të ndalojë vazhdimin e ndarjeve buxhetore për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës nëse Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr vendim për shkurtimin e buxhetit apo për shkak te rrethanave të paparashikuara apo mos mbylljes së periudhave sikurse është përcaktuar më poshtë në këtë Memorandum, gjatë vitit 2022 konform legjislacionit në fuqi.

## **9. ZBATIMI**

- 9.1. Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e tyre të përcaktuara në këtë Memorandum Bashkëpunimi, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi;
- 9.2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i edukimit fizik dhe sportit (FEFS) si dhe Federata e Sportit Shkollor të Kosovës (FSSHK), përcjellin zbatimin e Memorandumit, dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit të tij.

## **10. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE RRETHANAT E PAPARISHIKUARA**

- 10.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet njëanshmërisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në rastet e përcaktuara me pikat e lartë theksuara të këtij Memorandumi;
- 10.2. Më marrëveshje ndërmjet palëve;
- 10.3. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë Mbinatyrore Vis maior dhe rrethanave të tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim më palët e tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

## **11. AMANDAMENTIMI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një Marrëveshjeje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum Bashkëpunimi, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandum Bashkëpunimi në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MiB – i, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

## **12. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE**

Palët do të përpilen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrjnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Departamenti përkatës i Gjykatës Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tillë.

## **13. KOHËZGJATJA**

- 13.1. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit përfshinë mbështetjen për aktivitetet që shtrihen në harkun kohor prej një (1), përkatësisht gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022, përvèç nëse ndërpritet apo nëse janë shkelur kushtet e përcaktuara me këtë Memorandum Bashkëpunimi;
- 13.2. Specifikat e të drejtave dhe obligimeve të caktuara për vitin 2022 që nuk janë përfshirë në këtë kornizë të bashkëpunimit, mund të përcaktohen me një aneks të veçantë të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit gjatë vitit 2022.

## **14. KOPJET DHE GJUHA E MEMORANDUMIT**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në pesë (5) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## **15. HYRJA NË FUQI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

### **PALËT NËNSHKRUUESE**

Hajrulla ÇEKU

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Arbërie NAGAVCI

Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Rifat LATIFI

Ministër i Shëndetësisë

Naser SAHITI, rektor

Musa SELIMI, dekan

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit

Adrian TELAKU

Kryetar i Federatës së Sportit Shkollor e Kosovës

Nënshkruar më 06 / 12 / 2021  
Prishtinë